



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilijeno Më/Duna <u>16-05-2024</u> vll.gov			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vlerues
02-	035/02-		710



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011 lidhur me nenin 130 të Ligjit Mbi Prokurimin Publik Nr.04/L-042 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/19 shtator 2011, Prishtinë, kryetari i Komunës, në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore bjen këtë:

V E N D I M

Për Rregullaritet ligjorë për të gjitha Kompanitë në Komunën e Vitisë

Neni I

Me këtë vendim, obligohen të gjitha Kompanitë që kanë hyrë në raporte kontraktuale me fondet publike të Komunës së Vitisë –që kanë nënshkru kontrata ti kryejn punët konformë kontratës duke marrë parasysh qëllimin ,dinamikën.

Neni II

Obligohen sipas ligjit të gjitha Kompanitë që për punët e kryera me defekte të kthehen në piken zero.

Neni III

Komuna e Vitisë i trajton të barabartë dhe pa kurfar diskriminimi të gjithë Operatorët Ekonomik dhe në këtë kuptim do të veproj me transparencë të plotë .

Neni IV

Nëse operatori Ekonomik punët e kryera me defekte nuk i rikthen ,nuk e kryen plotësim ndryshimin, nuk i perfill vërejtjet e dhëna nga Komuna e Vitisë, atherë do ti ndjekim procedurat ligjore.

Neni V

Ky vendim hyn fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet:

1. Të gjitha Kompanive –Operatorve Ekonomik
2. Zyrës së Prokurimit
3. Zyrës Ligjore

z.Sokol Haliti

Kryetar Komune

